

VENDIM
Nr. 211, datë 28.7.2026

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “DOMA GROUP” SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HIDROCENTRALI “VINJOLLI 1”

Në mbështetje të neneve 16, 40, pika 2, germa “a” dhe 41, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, 13 dhe 14, pika 9, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.7.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1721/10 prot., datë 24.7.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Doma Group’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Doma Group” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1721 prot., datë 1.6.2026, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hidrocentrali “Vinjolli 1”, me vendndodhje në përroin e Varroshit, Manazdresë dhe Lajthit, degë të përroit Zall i madh, Bashkia Mat, qarku Dibër.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 167, datë 15.6.2026, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 16.6.2026 dhe 17.6.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 25.6.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua dhe në rrjetet sociale edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- ERE, po ashtu, ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, nëpërmjet shkresës nr. 1721/4 prot., datë 18.6.2026, ku i ka kërkuar të bëjë me dije nëse ka një qëndrim ndryshe, në lidhje me vlefshmërinë e kontratës dhe të drejtën e shoqërisë për ndërtimin dhe shfrytëzimin e këtij burimi gjenerues. Nga ana e MIE-s nuk ka pasur ndonjë qëndrim, në lidhje me fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë.

- Me shkresën nr. 1721/3 prot., datë 18.6.2026, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e fillimit të procedurës, si dhe informacionin/dokumentacionin që duhej të plotësohej në aplikim. Në vijim shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1721/5 prot., datë 29.6.2026, depozitoi dokumentacion plotësues, nga shqyrtimi i të cilit u vlerësua e nevojshme plotësimi i mëtejshëm i dokumentacionit për mbështetjen financiare, ndaj, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 191, datë 13.7.2026, u vendos zgjatja e afatit të vendimmarrjes së Bordit me 30 ditë.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1721/9 prot., datë 13.7.2026, shoqëria ka depozituar dokumentacionin e kërkuar.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, përfshirë dokumentacionin financiar dhe teknik të depozituar nga shoqëria, ku

rezulton se ajo ka paraqitur elementet e nevojshme që dëshmojnë kapacitetin për realizimin dhe operimin e objektit gjenerues, në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi.

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera:

Rezulton se shoqëria “Doma Group” sh.p.k. e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në përputhje me objektin e saj të përcaktuar në aktet e regjistrimit:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) nr. 641 rep., nr. 186/2 kol., datë 27.12.2018, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit ‘Vinjoll 1’ me kapacitet prodhues 1.840 mw, në përroin e Varroshit, Manazdresë dhe Lajthit, degë të përroit Zall i madh, Bashkia Mat, qarku Dibër”;

- Është pajisur me miratimin e pikës së lidhjes së HEC-it me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet shkresës së OSHEE sh.a., nr. 14690/3 prot., datë 25.7.2018, për kapacitetin 1860 kw. Kapaciteti i licencuar do të jetë 1.840 mw, në përputhje me kapacitetin e përcaktuar në kontratën me MIE-n dhe dokumentacionin e miratimit të projektit, pavarësisht kapacitetit teknik të pikës së lidhjes prej 1.860 kw të përcaktuar nga OSHEE sh.a.

- Është pajisur me lejen për përdorim burimi ujqor sipërfaqësor nr. 39 prot., datë 26.12.2023, lëshuar nga Këshilli i Basenit Ujqor (KBU) Mat, me afat vlefshmërie deri më 26.12.2028;

- Është pajisur me VNM paraprake, me nr. AN230520230011, datë 21.9.2023, Komisioni 96, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për zhvillimin e projektit “Ndërtim HEC ‘Vinjoll 1’”, me kapaciteti të instaluar 1.840 mw.

- Për sa më sipër, dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria rezulton të jetë në përputhje me objektin e kërkesës për licencim dhe mbulon elementet kryesore teknike, juridike dhe mjedisore të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Vinjoll 1”.

Kushtet dhe afatet ligjore:

- Në nenin 4, pika 4.1, të kontratës nr. 641 rep., nr. 186/2 kol., datë 27.12.2018, përcaktohet se koncesioni jepet për një afat prej 49 (dyzet e nëntë) vitesh, nga data e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate. Në nenin 5, pika 2, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, parashikohet se për aplikimet në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, të cilat paraqiten në ERE më vonë se data efektive e kontratës/autorizimit, llogaritja e afatit të licencimit, bëhet për periudhën e mbetur. Për sa më sipër, nga përllogaritja e afateve rezulton se shoqëria ka humbur rreth 8 vjet e 6 muaj dhe i mbetet rreth 41 vjet e 6 muaj nga afati i kontratës. Megjithatë, në zbatim të nenit 41, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”, sipas të cilit afati i vlefshmërisë së licencës për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nuk mund të jetë më shumë se 30 vjet, Për sa më sipër, duke marrë në konsideratë kufizimin ligjor të përcaktuar, si dhe afatet e mbetura nga kontrata koncesionare, vlerësohet që licenca të jepet për një afat 30-vjeçar (tridhjetëvjeçar).

- Shoqëria ka deklaruar se do të vendosë në punë centralin brenda datës 30.4.2027, pra brenda afatit të vlefshmërisë së përcaktuar në kontratën nr. 641 rep., nr. 186/2 kol., datë 27.12.2018. Në këto rrethana, vlerësohet të përcaktohet që shoqëria duhet të fillojë operimin brenda datës 30.4.2027.

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 10 të kontratës së nënshkruar me MIE-n, vlerësohet t’i lihet asaj kusht që, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga fillimi i operimit, të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës për testimin e veprës, dhe të depozitojë informacion të përditësuar, në lidhje me stafin teknik efektiv në strukturën e saj organizative.

- Shoqëria ka aktualisht një leje uji të vlefshme (deri në datën 26.12.2028), por duke qenë se ky afat nuk mbulon të gjithë periudhën e vlefshmërisë së licencës, vlerësohet që të përcaktohet që shoqëria duhet të depozitojë lejen e ujit të përditësuar brenda datës 26.12.2028.

- ERE rezervon të drejtën e rishikimit të këtij vendimi në rast të depozitimit të sa lënë detyrë shoqërisë dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.

- Në përfundim, vlerësohet se shoqëria ka përmbushur kushtet për licencim, me detyrimin për të respektuar afatet dhe detyrimet e përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Doma Group” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali “Vinjolli 1”, me vendndodhje në përroin e Varroshit, Manazdresë dhe Lajthit, Degë të përroit Zall i Madh, Bashkia Mat, qarku Dibër, për një afat 30-vjeçar (tridhjetëvjeçar).

2. Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 30.4.2027.

3. Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga fillimi i operimit, shoqëria duhet të dokumentojë në ERE testimin e veprës dhe të depozitojë informacion të përditësuar, në lidhje me stafin teknik efektiv në strukturën e saj organizative.

4. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE lejen e rinovuar për përdorimin e burimit ujqor brenda datës 26.12.2028.

5. Ky vendim është objekt rishikimi, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të pikave 2, 3 dhe 4 të këtij vendimi, dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.

6. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Doma Group” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, OSSH sh.a., FTL sh.a. dhe ALPEX sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
ANËTAR I BORDIT
Petra Lika